

Data 17.11.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Implementim i nje sistemi te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 35721000-4 -
Sistem elektronik i inteligjencës.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 149,981,100 ((njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind) lekë, pa TVSH, ose 1,547,952.32 (një milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy pikë tridhjetë e dy) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 17.11.2025, 1 euro = 96.89 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike, duke bere te mundur vetem Upgrade, zgjerim dhe permiresim te sistemit aktual. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nenin 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate faktin qe te krijohen kushtet per nje konkurrence te hapur dhe per te mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik qe ofrojnë këto lloj shërbimesh, pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit te shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe ne frymen e konkurueshmerise qe gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar qe OE ofertues te ketë bërë/realizuar me kontrata te ngjashme, te jetë rreth 35 % e vlerës (ne vijimesi edhe me LLP te meparshem) dhe ne këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë qe OE ofertues do jete realisht ne gjendje te realizoje kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- 3) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, per menaxhimin e sherbimeve te teknologjise se informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme jane percaktuar bazuar ne nenin 79, te ligjit nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 44 te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe si kompani kane kualifikimet / certifikimet e duhura organizative dhe operacionale te nevojshme per te zbatuar kontraten.

Konkretisht:

Kerkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001 ose ekuivalent, sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale ne menyre

cilesore dhe te plote, bazuar ne organizimin e brendshem per menaxhimin sa me te mire te cilesise implementuese. Ky certifikim kerkohet ne perputhje me proporcionalitetin e vleres se fondit limit te vendosur ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin dhe rendesine e funksionalitetit online te sistemeve aktuale qe OSHEE Group SHA ka ne perdorim.

Perkatesisht kjo lloj ISO specifikon kerkesat per nje sistem cilesor te menaxhimit te cilesise, kur nje organizate:

- Duhet te deshmoje kapacitetin per te siguruar vazhdimisht produktin qe kenaq klientin dhe kerkesat statutore dhe normative te aplikueshme.
- Synon te permiresoje kenaqjen e klientit, nepermjet aplikimit te sistemit, duke perfshire proceset per permiresimin e vazhdueshem te sistemit dhe garancise te konformitetit me klientin dhe kerkesat statutore dhe normative te aplikueshme.

Kerkesa Lidhur me certifikimin ISO 27001 ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke siguruar qe informacionet (siç jane ato qe permbajne sistemet ekzistuese te AK dhe e kane nje rendesi dhe konfidencialitet te larte) te menaxhohen ne menyre te sigurte nga pikepamja informatike dhe te jene te kontrolluara si dhe aksesimi mbi to te jete i verifikueshem e i kodifikuar. Kjo vjen pasi ne kete kontrate do te kete edhe perdorim te aplikacioneve te reja per diagnostikimin e elementeve te sigurise se sistemeve ekzistuese qe kerkojne kompetence te shtuar profesionale ne kete drejtim. Ky certifikim kerkohet ne perputhje me proporcionalitetin e vleres se fondit limit te vendosur ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin dhe rendesine e funksionalitetit online te sistemeve aktuale qe OSHEE Group SHA ka ne perdorim.

Kerkesa Lidhur me certifikimin ISO 20001-1 ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke qene se zoteron nje sistem menaxhimi per sherbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shume garanci qe ky i fundit te planifikoje, krijojë, zbatoje, monitorojë, rishikojë, mirembaje dhe permiresojë te gjithë sistemin ne teresi, i cili eshte teresisht i bazuar ne produkte TIK (software dhe hardware). Ky certifikim kerkohet ne perputhje me proporcionalitetin e vleres se fondit limit te vendosur ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin dhe rendesine e funksionalitetit online te sistemeve aktuale qe OSHEE Group SHA ka ne perdorim.

2.Operatori Ekonomik duhet te paraqese zgjidhjen teknike sipas kerkesave te parashikuara ne Dokumentet Standarde te Tenderit.

Argumentim: Ky argument eshte vendosur ne lidhje me kriteret teknike dhe eshte ne perputhje me Nenin 36 dhe Nenin 79 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020, “Per prokurimin

publik”, Nenin 44 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”.

3. Operatori pjesemarrës për të vertetuar që ka kapacitete njerezore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave të referencës të projektit, duhet të vertetojë se ka të punësuar që ka pakten **20 (njetë) punonjës** të siguruar, ku të përfshihen jo më pak se **10 (dhjetë) Inxhinierë/Specialistë** të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatike / Informatike Matematike / Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatike Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit, ku të vertetohen nepermjet diplomes, në mënyrë të kombinuar të këne Çertifikatat perkatese (si mëposhte) si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, nga të cilët:

- a) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar në Project management PMP ose ekuivalent.
- b) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për analizë biznesi ose ekuivalent.
- c) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për testues software ose ekuivalent.
- d) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin e bazave të të dhënave Microsoft/Oracle/IBM ose ekuivalent
- e) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për implementimin e bazave të të dhënave Microsoft/Oracle/IBM ose ekuivalent
- f) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim databaze Microsoft/Oracle/IBM ose ekuivalent
- g) Të pakten 4 (katër) punonjës të certifikuar si zhvillues/programues software back-end në JAVA, ose .NET ose PHP ose C++ ose ekuivalent
- h) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për programim web front-end me teknologjitë e njohura HTML,CSS,JavaScript, ose ekuivalent.
- i) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për arkitekturën e orientuar nga shërbimet SOA ose ekuivalent
- j) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për virtualizim ose ekuivalent
- k) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemet operative si MS. Windows Server ose LINUX ose UNIX ose ekuivalent
- l) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim trajnimesh ose ekuivalent
- m) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për implementime për software në fushën Utilities për CRM&Billing ose ekuivalent
- n) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për menaxhim të proceseve të biznesit (business process management) ose ekuivalent
- o) Të pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për UX Designer ose ekuivalent

Një punonjës mund të disponojë me shumë se një certifikim.

Per të vertetuar disponimin e stafit të mesipër operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata perkatese / Transkriptet perkatese / Diplomat.
- Listepagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, (duke marrë si referencë data e hapjes së ofertave).

Per të përmbushur këto kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetedeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit.

Lidhur me kërkesat që perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” te pikes 2 te 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin minimal te nevojshem per realizimin me sukses te kontrates.

Argumentimi Teknik: Per realizimin e ketij sherbimi kerkohen 10 (dhjete) specialiste qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdore personel teknik te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizes, si dhe numri i personelit te certifikuar, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit, si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve ne degët Inxhinierise Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatike / Informatike Matematike / Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatike Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references, pasi ky objekt prokurimi perfshin zhvillim, implementimin, adaptimin, testimin dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit, si dhe duhet te ofroje trajnim per perdoruesit.

Stafi i operatorit ekonomike duhet te disponoje certifikimet teknike si me poshte:

- a) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar ne Project management PMP ose ekuivalente.

Argumentim: Ky kriter garanton AK qe operatori ekonomik ka ne perberje te tij stafin me aftesi profesionale ne menyre qe i gjithë projekti te realizohet konform te gjitha kërkesave dhe afateve te percaktuara ne DST dhe specifikimet teknike. Dy punonjesit e certifikuar si menaxher projekti (backup te njeri tjetrit) garantojne organizimin e njerezve dhe burimeve te OE per te pasur zbatim te suksesshem te projektit sipas standarteve dhe praktikave me te mira nderkombetare, duke marre ne konsiderate rendesine dhe kompleksitetin e projektit. Nje menaxher projekti eshte pergjegjes per ndjekjen e te gjithë ciklit te nje projekti, qe prej analizes dhe dizenjimit te kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve te programit. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se “4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kërkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie

- b) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per analize biznesi ose ekuivalent.

Argumenti: Ky kriter garanton AK per aftesite profesionale per analizimin dhe perpunimin e te dhenave per objektin e kontrates, duke perdorur mjete dhe teknika te avancuara per zhvillimin dhe menaxhimin e bazave te te dhenave, duke siguruar integritetin dhe saktesine e te dhenave, bashkepunim me ekipin per te zhvilluar dhe implementuar strategji per mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave teknike, realizimi i

modeleve per integrim per te mbeshtetur vendimmarrjen dhe planifikimin per ekzekutimin sa me professional te kontrates. Gjithashtu

ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie*

c) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per testues software ose ekuivalent

Argumenti: Roli i testuesve software ne projektin per implementimin e sistemit te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes, eshte thelbesor per te garantuar qe te gjithë komponentet qe ndertohen apo integrohen ne kete sistem funksionojne ne perputhje me kerkesat funksionale dhe teknike, pa defekte qe mund te komprometojne performancen, sigurine apo besueshmerine e sistemit. Testuesit e certifikuar jane te afte te hartojne test cases te detajuara, te percaktojne skenaret e mundshem te deshtimit dhe te ekzekutojne testime te automatizuara apo manuale me perdorimin e mjeteve moderne. Ata kontrollojne qe te dhenat te qarkullojne ne menyre te sigurt dhe te panderprere midis komponenteve te sistemit, duke verifikuar qe çdo sherbim funksionon sipas skenareve te pritshem dhe qe nuk ka regresione funksionale gjate perditesimeve ose nderhyrjeve teknike. Testuesit perfaqesojne vijen e pare te mbrojtjes ndaj gabimeve dhe jane thelbesore per sigurimin e cilesise, qendrueshmerise dhe pranueshmerise se sistemit objekt prokurimi, perpara se ajo te kalohet per perdorim te gjere. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie*

d) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per administrimin e bazave te te dhenave Microsoft ose Oracle ose IBM ose ekuivalent

Argumenti: Ky kriter synon te garantoje qe operatori ekonomik i cili do te angazhohet ne realizimin e kontrates te zoteroje kapacitetin profesional dhe teknik te nevojshem per te administruar ne menyre te sigurt dhe efikase bazen e te dhenave te sistemit objekt prokurimi. Duke qene se baza e te dhenave eshte element kyc i çdo sistemi informacioni, administrimi i saj kerkon njohuri te specializuara dhe eksperience praktike qe provohen me se miri permes certifikimeve te njohura nderkombetarisht. Certifikimet Microsoft, Oracle, DB2 apo ekuivalente e tyre jane te pranuar globalisht dhe perfaqesojne njohurite minimale qe nje profesionist duhet te zoteroje per te administruar, optimizuar dhe siguruar bazat e te dhenave. Kerkesa per punonjes te certifikuar per administrimin e bazes se te dhenave eshte proporcionale me madhesine e ketij projekti dhe nuk vendos barre te panevojshme mbi operatoret ekonomike. Duke lejuar alternativa midis

Microsoft, Oracle, DB2 ose ekuivalenteve të tyre, kriteri nuk favorizon një teknologji të vetme dhe hap mundësi pjesëmarrjeje për operatore ekonomik që mund të ofertojnë platforma të ndryshme. Përcaktimi i “ose ekuivalent” siguron që edhe certifikime të tjera të pranuar ndërkombëtarisht mund të pranohen, duke ruajtur konkurrencën dhe shmangur diskriminimin. Gjithashtu ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë*

zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilesie

e) 5- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për implementimin e bazave të të dhënave Microsoft ose Oracle ose IBM ose ekuivalent.

Argumentim: Ky kriter është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik të ketë kapacitete të mjaftueshme teknike dhe profesionale për të implementuar në mënyrë të

suksesshme bazën e të dhënave të sistemit të integruar për menaxhimin dhe automatizimin e proceseve të punës gjatë zbatimit të kontratës. Implementimi i bazave të të dhënave kërkon njohuri të specializuara në dizajnim, konfigurim, optimizim dhe integrim me sisteme të tjera (sic është dhe rasti i sistemit të integruar për menaxhimin dhe automatizimin e proceseve të punës), të cilat nuk mund të mbulohen vetëm nga përvoja praktike, por kërkojnë gjithashtu standardizim dhe vërtetim përmes certifikimeve ndërkombëtare. Certifikatat nga Microsoft, Oracle, DB2 ose ekuivalenteve të tyre, provojnë që punonjësi zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të realizuar me sukses fazën e implementimit bazës së të dhënave, sipas praktikave më të mira. Gjatë implementimit përcaktohet arkitektura e bazës së të dhënave, konfigurimi fillestar, politikat e sigurisë, si dhe integrimi me sistemet ekzistuese. Gabimet në këtë fazë mund të sjellin pasoja të rënda për sigurinë, integritetin dhe performancën e sistemit. Punonjësit e certifikuar ofrojnë garanci se implementimi i bazës së të dhënave do të bëhet në përputhje me standardet teknike, duke krijuar një bazë të dhënash të qëndrueshme. Kërkesa për punonjës të certifikuar për implementimin e bazës së të dhënave është proporcionale me madhësinë e këtij projekti dhe nuk vendos barre të panevojshme mbi operatorët ekonomikë. Duke lejuar alternativa midis Microsoft, Oracle, DB2 ose ekuivalenteve të tyre, kriteri nuk favorizon një teknologji të vetme dhe hap mundësi pjesëmarrjeje për operatore ekonomik që mund të ofertojnë platforma të ndryshme. Përcaktimi i “ose ekuivalent” siguron që edhe certifikime të tjera të pranuar ndërkombëtarisht mund të pranohen, duke ruajtur konkurrencën dhe shmangur diskriminimin. Gjithashtu ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund*

te vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilesie.

f) Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim databaze Microsoft ose Oracle ose IBM ose ekuivalent

Argumentim: Kërkesa për punonjës të certifikuar në zhvillimin e databazave ka për synim të garantojë se operatori ekonomik disponon ekspertizën e nevojshme për të dizajnuar, zhvilluar dhe optimizuar strukturat e bazës së të dhënave që janë shumë të rëndësishme për funksionimin e sistemit objekt prokurimi. Ndryshe nga administrimi apo implementimi, zhvillimi i databazave kërkon njohuri të avancuara në modelim, krijimin dhe përpunimin e objekteve të bazës së të dhënave (tables, views, stored procedures), optimizimin e query-ve dhe sigurimin e performancës. Është thelbësorë për përshtatjen e sistemit me kërkesat funksionale të projektit. Një zhvillim i dobët i databazës çon në probleme të performancës, humbje kohe dhe kostosh shtesë. Punonjësit e certifikuar garantojnë që zhvillimet në nivelin e bazës së të dhënave do të jenë në përputhje me standardet e industrisë, duke siguruar integritetin e të dhënave dhe

reduktuar rrezikun e cenimit të tyre. Kërkesa për punonjës të certifikuar për zhvillimin e bazës së të dhënave është proporcionale me madhësinë e këtij projekti dhe nuk vendos barre të panevojshme mbi operatorët ekonomikë. Duke lejuar alternativën midis Microsoft, Oracle, DB2 ose ekuivalenteve të tyre, kriteri nuk favorizon një teknologji të vetme dhe hap mundësi pjesëmarrjeje për operatorë ekonomikë që mund të ofertojnë platforma të ndryshme. Përcaktimi i “ose ekuivalent” siguron që edhe certifikimet e reja apo të tjera të pranuar ndërkombëtarisht mund të pranohen, duke ruajtur konkurrencën dhe shmangur diskriminimin. Gjithashtu ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilesie.

g) Te pakten 4 (katër) punonjës të certifikuar si zhvillues/programues software back-end në JAVA, ose .NET ose PHP ose C++ ose ekuivalent

Argumentim: Kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik që merr përsipër zbatimin e kontratës të ketë kapacitete reale zhvillimi në pjesën me kritike të sistemit të integruar për menaxhimin dhe automatizimin

e proceseve te punes – logjiken back-end. Back-end eshte shtresa ku ndodhen proceset e biznesit, integrimi me databazat, sherbimet e sigurise dhe nderveprimi me sisteme te tjera. Kjo kerkon burime njerezore me njohuri te thelluara teknike dhe me kompetence te verifikuar permes certifikimeve te njohura nderkombetarisht. Zhvillimi i logjikes se biznesit, sherbimeve API (web services), mekanizmeve te autentikimit dhe integrimi me sisteme te tjera (sistemet ekzistuese), kerkon ekspertize te larte teknike. Vetem punonjesit me certifikata perkatese mund te garantojne korrektesi dhe siguri ne keto procese. Certifikimet ne JAVA, .NET, PHP, C++, ose ekuivalentet e tyre, perfaqesojne nje standard nderkombetar qe verteton njohurit e teknike dhe aftesine praktike te zhvilluesve ne keto gjuhe dhe platforma programimi. Punonjesit e certifikuar jane te afte te implementojne praktikat me te mira te programimit, duke reduktuar ndjeshem rrezikun e gabimeve kritike ose cenimeve te sigurise. Duke lejuar alternativa midis JAVA, ose .NET ose PHP ose C++ ose ekuivalenteve te tyre, kriteri nuk favorizon nje teknologji te vetme dhe hap mundesi pjesemarrjeje per operatore ekonomik qe mund te ofertojne sisteme te programuar ne gjuhe te ndryshme programimi. Percaktimi i “ose ekuivalent” siguron qe edhe certifikimet e reja apo te tjera te pranuar nderkombetarisht mund te pranohen, duke ruajtur konkurrencen dhe shmangur diskriminimin. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se “4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.

h) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per programim web front-end me teknologjite e njohura HTML, CSS, JavaScript, ose ekuivalent.

Argumentim: Ky kriter eshte vendosur per te garantuar qe operatori ekonomik disponon burime njerezore te kualifikuara per zhvillimin e nderfaqes se perdoruesit (front-end), qe eshte elementi kryesor i nderveprimit mes perdoruesit dhe sistemit objekt prokurimi. Kriteri synon te

siguroje qe operatori ekonomik qe merr persiper zbatimin e kontrates te kete kapacitete reale zhvillimi per pjesen front-end te sistemit te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes. Perdoruesmeria, performanca dhe qasja (accessibility) e aplikacionit varen drejtperdrejt nga cilesia e zhvillimit front-end. HTML, CSS dhe JavaScript, ose ekuivalent te tyre, perbejne bazen e çdo aplikacioni modern web. Ato jane teknologjite me te perdorura globalisht per ndertimin e nderfaqeve funksionale dhe interaktive. Programuesit e certifikuar jane te afte te implementojne praktikat me te mira ne programim, optimizimin e performances se aplikacionit dhe respektimin e standardeve nderkombetare te qasjes dhe kompatibilitetit. Perfshirja e termit “ose ekuivalent” siguron qe pervec HTML, CSS dhe JavaScript, pranohen edhe certifikime te tjera te njohura nderkombetarisht mbi teknologjite moderne front-end (p.sh. Angular, React, etj.), duke ruajtur konkurrencen e hapur. Kriteri nuk kufizon pjesemarrjen e operatoreve ne baze te nje teknologjie te vetme, por i le te lire te perdorin teknologji alternative

te certifikuara. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.*

i) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per arkitekturen e orientuar nga sherbimet SOA ose ekuivalent

Argumentim: Ky kriter eshte vendosur dhe synon te garantoje se operatori ekonomik disponon ekspertizen e nevojshme per te ndertuar sisteme te bazuara ne arkitekturen e orientuar nga sherbimet (SOA) ose ne paradigma ekuivalente te arkitektures se nderveprimit te sherbimeve (p.sh. microservices, event-driven architecture). Keto jane modele moderne qe sigurojne modularitet, shkallezim dhe lehtesi integrimi me sisteme te tjera. Implementimi i sistemit te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes kerkon dhe nderveprim me sistemet ekzistuese te OSHEE, duke perdaruar API me arkitekture SOA. Krijimi dhe menaxhimi i nje arkitekture SOA kerkon ekspertize te thelluar ne projektim, orkestrimin e sherbimeve, menaxhimin e mesazheve dhe integrimin e sistemeve heterogjene. Pa profesioniste te certifikuar, rrezikohet cilesia dhe funksionaliteti i te gjithe sistemit objekt prokurimi. Certifikimet ne SOA (ose ekuivalente) sigurojne qe punonjesit njohin praktikat me te mira per implementimin e sherbimeve te sigurta dhe te standardizuara, te afta per t'u integruar me sisteme te ndryshme. Perfshirja e termit “ose ekuivalent” siguron qe, pervec certifikimeve te dedikuara per SOA, pranohen edhe certifikime te tjera te krahasueshme, ekuivalente. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.*

j) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per virtualizim ose ekuivalent

Argumentim: Ky kriter ka per qellim te garantoje qe operatori ekonomik disponon ekspertizen e nevojshme ne virtualizim te infrastruktures. Sistemi objekt kontrate do te implementohet ne disa makina virtuale si dhe sqaruar ne specifikimet teknike. Per kete arsye, eshte e

domosdoshme qe ne perberje te ekipit te operatorit zbatues te kete te staf te certifikuar per virtualizim ose ekuivalent. Certifikatat nga prodhues kryesore (p.sh. VMware, Microsoft Hyper-V, Oracle VM, RedHat Virtualization) ose ekuivalente te tyre deshmojne njohuri praktike ne konfigurimin, menaxhimin dhe optimizimin e mjediseve te virtualizuara. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.*

k) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per sistemet operative si MS. Windows Server ose LINUX ose UNIX ose ekuivalent

Argumentim: Me qellim mbeshtetjen teknike gjate instalimit dhe konfigurimit te sistemit te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes objekt kontrate, duhet prezenca e stafit te OE me aftesi te certifikuara ne sistemet operative, i cili do te pergatise sistemin operativ sipas nevojave te projektit, ne teknologji te ndryshme ne perputhje me specifikimet teknike. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.*

l) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per zhvillim trajnimesh ose ekuivalent

Argumentim: Ky kriter eshte vendosur dhe synon te garantoje qe operatori ekonomik te kete kapacitetin profesional dhe pedagogjik per te zhvilluar dhe ofruar programe trajnimi te strukturuara, te cilat jane pjese perberese e çdo projekti IT qe perfshin futjen e sistemeve te reja. Trajnimi i stafit perdorues dhe i administratoreve eshte thelbesor per te siguruar perdorim efektiv dhe te qendrueshem te zgjidhjes se implementuar per sistemin e integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes. Certifikimi deshmon njohuri per hartimin e moduleve te trajnimit, pershtatjen sipas profilit te perdoruesve, si dhe perdorimin e metodave te vleresimit per te matur efektivitetin e trajnimit. Punonjesit e certifikuar jane te afte te garantojne qe njohurite teknike te kalohen ne menyre efektive tek stafi i autoritetit kontraktor, duke rritur pavaresine operacionale dhe duke ulur varesine nga furnitori. Trajnimet e zhvilluara sipas standardeve te certifikuara garantojne qe stafi i brendshem te jete i pergatitur per perdorimin dhe administrimin e sistemit. Perfshirja e termit “ose ekuivalent” lejon pranimin e certifikatave nga nje game e gjere metodologjish dhe institucione trajnimi, duke ruajtur konkurrencen dhe shmangur kufizimet teknologjike. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.*

m) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per implementime per software ne fushen Utilities per CRM&Billing ose ekuivalent

Argumentim: Ky kriter synon te garantoje qe operatori ekonomik zoteron ekspertizen e nevojshme per software te specializuar per implementime per software ne fushen Utilities per CRM&Billing (sic eshte rasti i OSHEE), i cili ka karakteristika specifike dhe dallime te rendesishme nga sistemet e zakonshme IT. Duke qene se integrimi kryesor i sistemit te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes, eshte me sistemin ekzistues te OSHEE per CRM dhe Billing eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik te kete ne stafin e tij te propozuar ne project, punonjes qe kane njohuri dhe jane te certifikuar per implementime software ne fushen Utilities per CRM&Billing. Perdorimi i stafit te certifikuar siguron qe projekti per implementimit te sistemit te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes, te zbatohet sipas standardeve nderkombetare te industrise. Certifikatat software per implementime ne fushen Utilities per CRM&Billing sigurojne qe punonjesit zoterojne njohurite e nevojshme per projektim, konfigurim dhe optimizim te proceseve kritike ne fushen e sistemeve IT per utilities. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me

nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se *“4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie*

n) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per menaxhim te proceseve te biznesit (business process management) ose ekuivalent

Argumentim: Ky kriter eshte vendosur per te garantuar qe operatori ekonomik disponon burime njerezore te specializuara per implementim/ridizenjim te proceseve te biznesit (p.sh. planifikimi i ekipeve ne terren, monitorimi i KPI-ve, oraret, eskalimet dhe automatizimet etj). Kjo kerkon njohuri metodologjike te formalizuara ne Business Process Management. Operatoret ekonomik qe kane staf te certifikuar me njohuri Business Process Management jane thelbesore per te siguruar qe proceset e reja dixhitale te mos jene thjesht “migrim teknologjik”, por transformim real i menyres se punes — çka eshte nje kusht kyç per suksesin afatgjate te sistemit objekt prokurimi. Punonjesit e certifikuar ne Business Process Management garantojne qendrueshmeri institucionale dhe aftesi per pershtatje dhe zhvillim te metejshe me sistemit edhe pas perfundimit te implementimit nga kontraktori. Stafi i certifikuar siguron qasje te standardizuar ne modelimin dhe optimizimin e proceseve, duke reduktuar varesine nga furnitoret dhe kostot e mirembajtjes ne afatgjate. Kjo ndihmon ne mirembajtje te vazhdueshme te sistemit, sidomos ne rast ndryshimesh organizative, rregullatore ose teknologjike.

o)Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per UX Designer ose ekuivalent

Argumentim: Ky kriter eshte vendosur per te garantuar qe operatori ekonomik disponon burime njerezore te specializuara ne dizajnimin e pervojes se perdoruesit (UX Design), e cila eshte thelbesore per suksesin e çdo aplikacioni apo sistemi. Nje sistem mund te jete teknikisht korrekt, por nese nuk eshte i lehte per t'u perdorur dhe nuk i pergjigjet nevojave te perdoruesve fundore, efikasiteti i tij bie ndjeshem. UX Designer-s te certifikuar sigurojne qe nderfaqet dhe rrjedhat e punes te jene intuitive, te thjeshta dhe ne perputhje me praktikatat me te mira nderkombetare. Certifikimet ne UX Design ose ekuivalente, vertetojne njohurite mbi prototipimin, testimin e perdorshmerise, dizajnin e qasjes (accessibility) dhe perputhshmerine me standardet e perdorshmerise. Perfshirja e termit “ose ekuivalent” siguron qe te pranohen nje game e gjere certifikatash nderkombetare, duke perfshire ato nga institucione akademike dhe qendra te specializuara ne dizajn. Kriteri nuk kufizon konkurrencen tek nje certifikate ose teknologji e vetme, por vendos nje standard minimal te nevojshem per te garantuar cilesine e pervojes se perdoruesit. Gjithashtu ky kriter eshte vendosur ne perputhje me nenin 77 pika (4) te LPP, ku parashikohet se “4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet

e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.